


Përqindja e fëmijëve 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar




OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE
QARKU DIBËR




Qarku i Dibrës ka një popullsi prej 180,507 banorë¹. Ai përbëhet nga Rrethi Dibër, Mat dhe Bulqizë, me 35 Komuna dhe Bashki përkatësisht: 4 Bashki dhe 31 Komuna. Qyteti i Dibrës është qyteti më i rëndësishëm në Qark, i cili është edhe qendra e Prefekturës dhe e Qarkut Dibër.



Qarku i Dibrës është pjesë e nën-rajonit verilindor të Shqipërisë. Kufizohet në lindje me Maqedoninë, në veri me qarkun e Kukësit, në veriperëndim me qarkun e Lezhës, në perëndim me qarkun e Durrësit dhe Tiranës dhe në jug me qarkun e Elbasanit. Qarku i Dibrës është



¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011



prekur shumë nga lëvizja demografike e popullsisë pas viteve '90; sot popullsia është e qëndrueshme me një tendencë të lehtë rritje.



Përshkrim mbi situatën e të drejtave të fëmijëve në Qark:

Qarku i Dibrës në vitin 2010, ka 180.507¹ banorë dhe 48.394² familje në total. Nga numri total i familjeve në qark, 9.099 familje (16.4%) janë familje të varfra dhe kanë fëmijë (grupmosha 0-15 vjeç). Fëmijët (0-18 vjeç) përbëjnë 33.4 % të popullsisë (60.356 fëmijë).

Në vitin 2010 në Qarku Dibër 1 në 2 fëmijë (ose 13.902 fëmijë) të grupmoshës 6-15 vjeç jetonte në familje të cilat trajtoheshin me Ndihmë Ekonomike (NE).

1 Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme, Mars 2011

2 Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)

Situata e fëmijëve të varfër në këtë Qark, ka ardhur duke u përqesuar nga viti në vit. Kështu raporti në vitin 2009 ishte 1 në 5 fëmijë (ose 7.282 fëmijë) të varfër në krahasim me 1 në 2 fëmijë që ishte në vitin 2010.

Përqindja e familjeve që mbështeten me ndihme ekonomike që kanë fëmijë të moshës 0-15 vjeç – Dibër wshtw e lartë në zonat rurale malore dhe kryesisht në Komunitet: Selishtë (48.8%), Arras (47.1%), Zall Dardhë (45.7%), Luzni (40.8%), Lurë (40.2%), Xibër (36.9%), etj. Këto komuna, si në vitin 2009³ ashtu dhe në vitin 2010 vazhdojnë të jenë komuna me familjet më të varfra, në Qarkun e Dibrës.

Në Qarkun Dibër, për vitin 2010 janë 1.525⁴ fëmijë të moshës 0-18 vjeç me aftësi të kufizuar (PAK), ose 2.5% të fëmijëve, duke klasifikuar Qarkun si qarkun me përqindje më të lartë në shkallë vendi. Nëse krahasojmë numrin e fëmijëve që jetojnë në zonë urbane me ato në zonë rurale, rezulton se 417 ose 34% jetojnë në qytet dhe 1.108 fëmijë ose 66% e fëmijëve me aftësi të kufizuar (0-18 vjeç) jetojnë në fshat.

Nga 1.525 fëmijë me aftësi të kufizuara në nivel qarku, vetëm 10 prej tyre frekuentojnë një qendër ditore në qytetin e Peshkopisë.

Në Qarkun Dibër, tre komunat që kanë numrin më të lartë të fëmijëve me aftësi të kufizuar (0-18 vjeç) janë Komsa 91 fëmijë (5.5%), Zall Dardhë 45 fëmijë (5.1%) dhe Suç 54 fëmijë (5%). Vendndodhja e këtyre komunave është jo vetëm malore por dhe larg qendrave urbane të Qarkut, duke e bërë të vështirë shërbimin dhe jetesën e fëmijëve dhe familjarëve të tyre.

3 Përqindja e familjeve që mbështeten me NE dhe kanë fëmijë 0-15 vjeç për vitin 2009, për komunat e përmendura për vitin 2010 është: Selishtë (51.46%), Xibër (50.39%), Zall Dardhë (43.33%), Arras (43.33%), Lurë (43.33%), etj

4 Burimi: Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë (Prill 2011)

Observatori për të drejtat e fëmijës është një strukturë vëzhguese e shoqërisë civile e ngritur në qarkun e Dibrës në vitin 2009, e cila në bashkëpunim të ngushtë me të gjithë aktorët vendorë publikë e jo-publikë bën mbledhjen sistematike të të dhënave dhe përgatit raporte dhe informacione periodike për aktorët lokalë dhe kombëtarë lidhur me situatën e fëmijëve, shkeljen e të drejtave, zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe nevojat për përmirësimin e tij të mëtejshëm.





Observatori për të drejtat e Fëmijëve, Qarku Dibër gjendet në

Lagjia: "Gjokë Doçi"

Rruga: Bulevardi "Elez Isufi", Qendra e biznesit, kati III,

Dibër, Shqipëri

e-mail: observatori_di@yahoo.com



Politika Rajonale në ndikojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve

Respektimi i të drejtave të fëmijëve ka hyrë si një nga çështjet prioritare në programin e Këshillit të qarkut Diber, organi më i lartë vendimmarrës në nivel rajoni. Ky institucion me mbështetjen e UNICEF dhe në partneritet me strukturat dhe aktorët e ndryshëm lokalë dhe rajonalë janë në proces finalizimi të strategjisë për fëmijët për Qarkun Diber. Gjithashtu pranë Këshillit të Qarkut funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve, si pjesë integrale e strukturës së qarkut.

Në dobi të realizimit dhe përmbushjes të të drejtave të fëmijëve, në Qarkun Diber, veç zyrës së Observatorit është ngritur dhe funksionon Njësia për të Drejtat e Fëmijëve në Qark.

	Bulqizë	Diber	Mat
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin parashkollor ¹	859	1924	1455
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e detyruar ²	4650	11447	7944
Numri i fëmijëve të regjistruar në arsimin e mesëm ³	1278	3404	2697

Shënim: Të dhënat "Përqindja e fëmijëve që jetojnë pa ujë të përmirësuar të pijshëm, energji elektrike, që jetojnë në banesa të papërshtatshme dhe përqindja e fëmijëve me 1 ose 2 prindër të pa punë", - janë marrë nga studimi i thelluar me autorë A. Ceni dhe V. Kolpeja.

